



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.6/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Rustem Thaqi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lart ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me ankesën e Rjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese dhe Internews Kosova (BIRN dhe IKS), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër komisionerëve të qendrës së votimit, lidhur me mospërputhjen të numrit të nënshkrimeve, për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar në Komunitet: Mitrovica e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan, në seancën e panelit të mbajtur me 20.05.2019, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e BIRN dhe IKS, që identifikohet me shenjën Anr.6/2019 e datës 20.05.2019

A r s y e t i m

Me datën 20.05.2019, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga BIRN dhe IKS me të cilën pretendon se në qendrën e votimit me nr.2901/04R në Zveçan, pas numërimit të votave ka rezultuar se në kuti kanë qenë më shumë vota se nënshkrime. Sipas të dhënave të konstatuara nga vëzhguesit e tyre, numri i fletvotimeve në kuti ka qenë 409 ndërsa numri i nënshkrimeve ka qenë 410. Sipas pretenduesit të ankesës në këtë vendvotim ka mospërputhje të numrit të nënshkrimeve me fletëvotimet në kuti.

PZAP-i, pas shqyrtimit të shkresave e lëndës, në kuptim të nenin 117 par.3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar:

Paneli pas vlerësimit të pretendimeve ankimore gjeti se parashtuesi në ankesë me asnjë provë bindëse nuk i ka argumentuar me prova pretendimet e tij në ankesë. Prandaj, Paneli ankesën e konsideron si të përgjithësuar dhe të pa argumentuar me fakte dhe si të tillë jo bindës pasi që nuk i plotësoj kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 117 paragrafi 3 i LZP-së.

Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të provave, shkresave lidhur me pretendimet e paraqitura në ankesë, vlerësohet se ankesa në fjalë është e pabazuar dhe e pa argumentuar dhe si e tillë e refuzoi si të pabazuar.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në mbështetje të nenit 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 6/2019 më datën 20.05.2019

Kryesuesi i Panelit
Fejzullah Rexhepi

Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve, nga momenti i marrjes pranimit të këtij vendimi.

